

VENDIM
Nr. 20, datë 9.1.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LABINOT - MAL TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Labinot - Mal të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Labinot - Mal të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr. 456, datë 6.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Labinot - Mal, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Labinot - Mal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Labinot-Mal-Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
668-681	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
682-688	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
779-813	Prona që përdoren për shërbime funerale	Në pronësi
707-711,715,720,732-738,743-744,747-750,752,766-778	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (troje)	Në përdorim
1086-1087,1091,1092,1096-1097,1101-1102,1106-1107,1111-1112,1118-1119,1121,1124-1125,1129-1130	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1088-1090,1093-1095,1098-1100,1103-1105,1108-1110,1113-1115-1117,1120,1122-1123,1126-1128,1131-1134	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
814-1077	Infrastrukturë (rugë vendore)	Në pronësi
712-714,716-719,721-731,739-742,745-746,751,753-765	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (sheshe)	Në pronësi
689-697	Prona që përdoren për zhvillim ekonomik	Në pronësi
661-667	Prona që përdoren për programe administrative	Në pronësi